

Kontratë Qiraje

Lokali i Shoqatës Bashkimi

BASHKIMI

Shoqata Kulturore Shqiptare
Albanischer Kulturverein

| Uster



Qiramarrësi

Emri, Mbiemri	
Adresa	
Numri Postal / Vendi	
Telefoni	
E-Mail	

Arsyja e Qiras:

--

Përdorimi:

Data	
Koha e Qiras	<input type="radio"/> 7:00 - 15:00 <input type="radio"/> 16:00 - 23:30
Audio / Video*	<input type="radio"/> Jo <input type="radio"/> Po +20 SFR <i>Në bazë të Rregullores (Pika 46), përdorimi i Projektorit dhe Abonimit "Digjitalb" kushton 20 SFR</i>
Kuzhina	<input type="radio"/> Jo <input type="radio"/> Po <i>Në bazë të Rregullores (Pika 45), Furra dhe Pjatalarsja (Geschirrspüler) nuk mund të përdoren</i>
Bibloteka	<input type="radio"/> Jo <input type="radio"/> Po
Çmimi Total	<input type="radio"/> 100 SFR <input type="radio"/> 200 SFR <input type="radio"/> 300 SFR <input type="radio"/> _____ SFR

Keni lexuar me vëmendje Kushtet e qirasë dhe pajtoheni me të gjitha pikat e Kontratës

Po Jo

Kushtet e qirasë zbatohen në pjesën e prapme të kësaj kontrate. Me nënshkrimin e tij qiramarrësi konfirmon marrëveshjen e tij me rregulloret.

Qiramarrësi

Përgjegjësi nga Shoqata Bashkimi

Emri		
Vendi / Data		
Nënshkrimi		

Termet dhe kushtet e përgjithshme – (AGB - Allgemeine Geschäftsbedingungen)

1. Shoqata Kulturore Shqiptare Bashkimi në Uster për anëtarët e saj lejon dhënien me qira lokalin në Berchtoldstrasse 10.
2. Lokali është pronë e Komunës Uster dhe administrohen nga Shoqata Bashkimi dhe të gjitha pajisjet e instaluar në Lokal (Mobilier, pajisjet Elektronike, Enët etj.) janë pronë e Shoqatës Bashkimi.
3. Qiramarrësit janë të vetëdijshëm që Lokali i Shoqatës Bashkimi duhet të përdoret me kujdesin e duhur.
4. Qiramarrësit marrin përgjegjësi të plotë për hapësirën e marrë me qira, përdorimin e mobileve dhe infrastrukturës deri në kthimin e personit të emëruar nga Shoqata.
5. Shoqata Bashkimi mund të refuzojë dhënien e Lokalin me Qira për arsye të vijuara në **Nenin 30**
6. Koordinimi i pikave (Data, Koha, Arsyeja e Rezervimit si dhe Pagesa) duhet të bëhen me shkrim (Mietveretrag) dhe të nënshkruar nga të dy palët (Shoqata Bashkimi dhe Qiramarrësi)
7. Në raste mosmarrëveshje dhe rezervim të dyfishtë, duhet të konsiderohet ai i pari që ka kërkuar me shkrim apo ka të konfirmuar rezervimin.
8. Në raste të interesimit për data të veçanta më shumë se një i interesuar dhe nuk vjen deri te marrëveshja midis të interesuarve, atëherë mund të zgjidhet ky problem me short. Shorti duhet të bëhet gjatë kohës kur të gjithë të interesuarit të jenë të pranishëm. Shortin e udhëheq njëri nga Anëtarët e Kryesisë.
Datat të veçanta: 31.Dhjetor / 01.Janar / 02.Janar / 8.Mars / 17.Shkurt / 28.Nëntor.
9. Në raste ku identifikohet gabimi i rezervimit nga ana e Shoqatës Bashkimi, mund të bëhen lëshime në çmim të qirasë apo të zgjidhet problemi në favor të Qiramarrësit.
10. Rezervimi është i vlefshëm vetëm nëse qiramarrësi ka në formë me shkrim (Email, Whatsapp, Viber, SMS etj). Çdo premtim gojor nuk është i vlefshëm në raste konflikti me qiramarrësit tjerë që posedojnë rezervim me shkrim.
11. Anulimi i rezervimit duhet të bëhet para 48 orëve të Terminit.
12. Nëse qiramarrësi nuk lajmërohet deri në datën e rezervimit, Shoqata Bashkimi detyrohet ti dërgojë faturë të plotë qiramarrësit.
13. Rezervimin e Lokalit mund ta bëjnë personat mbi moshën 18 vjeçare. Rezervimet për familjarë nën moshën 18 vjeçare (fëmijët e qiramarrësit) mund të aprovohet vetëm nëse qiramarrësi garanton prezencën e së paku një të rrituri nga Familja dhe dispozicion Anëtarësinë e Shoqatës Bashkimi.
14. Qiramarrësi duhet të lajmërohet disa ditë para se të vijë data e rezervimit që të koordinohen punët për sqarimet e Rregullores dhe dorëzimin e Çelësit.
15. Përgjegjësi i Lokalit apo zëvendësi i tij duhet të dorëzojë çelësin në datën kur është rezervuar Lokali. Është e ndaluar të dorëzohet çelësi para kohe.
16. Në rast se qiramarrësi e humb çelësin, ai është i detyruar të paguaj 300.- Sfr për ndërrimin e sistemit të derës.
17. Qiramarrësi është i detyruar që Lokalin ta dorëzojë në gjendje të pastër ashtu si e ka marrë. Nëse kjo nuk ndodh, shoqata detyrohet të ja llogaris kohën e pastrimit (50.- SFR. në orë).
18. Qiramarrësi është i detyruar që të informoj përgjegjësit (Shoqata Bashkimi) për çdo dëm që është bërë brenda kohës kur e kanë marrë Lokalin.
19. Personi i autorizuar nga Shoqata Bashkimi është i detyruar të kontrollojë Lokalin dhe infrastrukturën dhe të mbajë me shkrim çdo ndryshim. Paraprakisht mbas dorëzimit të informoj Kryesinë dhe qiramarrësin për veprimet.
20. Është e ndaluar çdo lloj pengese me zhurmë nëpër korridore të ndërtesës.
21. Qiramarrësi është i detyruar që prej orës 22.00 të festojë me dritare të mbyllura dhe në norma të shtetin Zvicëran.
22. Qiramarrësi është i detyruar që zhurma të reduktohet mbas orës 24.00.
23. Të gjitha ankesat ose gjobitjet përgjigjet qiramarrësi. Kjo vlen edhe për raste kur mysafirët e tij e bëjnë diçka të tillë.
24. Çdo fatkeqësi që ndodh në Lokal brenda kohës së huazimit, Shoqata Bashkimi nuk mban përgjegjësi.
25. Në Lokal të Shoqatës por edhe në sipërfaqen brenda ndërtesës (Zeughaus) është rreptësishtë e ndaluar pirja e duhanit.
26. Po ashtu janë të ndaluara të gjitha ndezjet e Zjarreve tjerë si Petardë, Qirinj apo tjera gjëra që ndihmojnë hapjen e zjarreve.
27. Në Lokal të Shoqatës nuk është e lejuar të përdoret Grilli privat me gaz ose me rrymë.
28. Përgjegjësi i Lokalit (Shoqata Bashkimi) mund të refuzoj dhënien e Lokalit në raste të arsyeshme.
29. Refuzimi duhet të deklarohet me shkrim të dy palëve. Kryesisë po ashtu edhe Qiramarrësit.
30. Refuzimi i Lokalit mund të argumentohet nëse ka argumente të tilla si:
 - a. Qiramarrësi nuk ka paguar qiranë nga hera e kaluar.
 - b. Qiramarrësi në të kaluarën ka bërë dëme të Lokalit dhe nuk i ka deklaruar.
 - c. Ka pasur ankesa të dokumentuara nga fqinjët në raste të mëparshme.
 - d. Qiramarrësi keqpërdor Lokalin për përfitime financiare.
 - e. Qiramarrësi shkel apo ka shkel rregulloren e Lokalit në të kaluarën.
 - f. Qiramarrësi nuk e ka paguar Anëtarësinë në Shoqatë.

31. Lokalin kanë të drejtë ta marrin me qira vetëm personat që identifikohen si anëtarë të Shoqatës Bashkimi me një pagesë të kryer mbi **3 Muaj**.
32. Qiramarrësi ka të drejtë të shërbehen nga pijet të cilat detyrohet ti paguaj në kohën të dorëzimit të Lokalit.
33. Shoqata Bashkimi detyrohet të informoj qiramarrësin për çmimet e pijeve. Pijet duhet të jenë të inventarizuara para marrjes së Lokalit dhe të numërohen para dorëzimit të Lokalit gjë që të identifikohet sasia e shërbimit. Sasia duhet të shënohet dhe informohet Qiramarrësi.
34. Çmimorja mirëmbahet nga Kryesia e Shoqatës Bashkimi. Çdo ndryshim duhet të aprovohet nga Kryesia në formë me shkrim.
35. Qiramarrësit i lejohej ti përdorë pijet personale. Mbase të përfundoj koha e huazimit, qiramarrësi detyrohet ti marrë pijet prapë me vete nëse kërkohet nga Shoqata Bashkimi.
36. Lokali ka makinën e kafes ku po ashtu mund të përdoret nga Qiramarrësi. Patronat (Kapsel) e kafes duhet të kërkohen para se të fillojë huazimi i Lokalit. Ato do të numërohen në përfundim dhe do të shënohet çmimi në bazë të përdorimit.
37. Qiramarrësi nuk ka të drejtë të përdorë Patrona të Kafes private në makinën (Kaffeemaschine) e Shoqatës.
38. Qumështi dhe Sheqeri për kafe është i përfshirë në Çmim të kafes.
39. Qiramarrësi detyrohet që hedhjen e mbeturinave (Abfallentsorgung) ta marrë me vete ose të bëjë pagesën e thasëve që ja ofron Qiradhënësi.
40. Qiramarrësi detyrohet që ti informojë mysafirët e vet për mundësinë e parkimit në rrethanat e Lokalit.
41. Çdo vërejtje apo dënim nga Policia ose përgjegjësit e parkingjeve për mysafirët shkon në përgjegjësinë e Qiramarrësit.
42. Për raste transporti mund të afrohen Veturat deri te hyrja e Lokalit për kohën deri ta të shkarkohen apo ngarkohen Materiali.
43. Parkingu shtetëror me pagesë është diku 50 metra afër Lokalit. Të Dielën ose çdo ditë mbas orës 20.00 është Parkingu falas.
44. Çdo të Premte gjatë kohës kur fëmijët vallëzojnë (18:00 – 22:00), lokali është i rezervuar për Prindërit që të kalojnë qasje së bashku. Gjatë kësaj kohe është njëri nga Kryesia që hap derën dhe mbyll kur të përfundon koha.
45. **Furra** dhe **Pjatarësja (Geschirrspühler)** nuk mund të përdoren nga Qiramarrësit. Shkaqet kryesore janë: mungesa e Ventilimit të duhur dhe rryma e pa kontrolluar.
46. Përdorimi i Projektorit (Beamer) dhe i Abonimit Digitalb është fakultativ (optional) dhe duhet të paguhet 20 SFR shtesë në dëshirohet nga Qiramarrësi.
47. Personi që merr Lokalin me Qira (Nënshkruesi) duhet të jetë prezent gjatë tërë kohës së nënshkruar.
48. Shitjet e ditës duhen të numërohen dhe të shënohen në Listën te Kasa.

Çmimorja

Çmimorja për Anëtarët e Shoqatës Bashkimi

Qiraja	100.00 SFR.
Paradite :	07:00 - 15:00
Mbas dite:	16:00 - 24:00

Gjatë orës 15:00 - 16:00 është një pauzë për pastrim.

Speciales:

Qiraja e Lokalit për Festën e Vitit të Ri	300.00 SFR.
Nata e dytë dhe e tretë	200.00 SFR.

Kjo Rregullore është miratuar më datën 14. Nëntor. 2019 e aprovuar nga Kryesia e Shoqatës Bashkimi dhe hyn në fuqi me datën **01. Dhjetor 2019**.

Uster, 14. Nëntor. 2019
Kryesia e Shoqatës Bashkimi